



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1411/3 Prot.

Tiranë, më 22.12.2022

**V E N D I M**

**Nr. 227, Datë 22.12.2022**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 165, datë 28.10.2022, e R.A kundër Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a (FSHU), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “moshës<sup>1</sup>” dhe “çdo shkak tjetër<sup>2</sup>”.

Në vijim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “Jam R.A banues në qytetin e Shkodrës dhe kam në pronësi dy shtëpi, si rrjedhojë kam të lidhura dy kontrata me FSHU-në. Në njërin shtëpi banoj unë, kurse në shtëpinë tjetër nuk banon njeri. Në muajin Shtator 2022 unë faturohem njësoj për të dy banesat në vlerën 2733.40 lekë<sup>3</sup>. Ndërkohë që në faturën e muajit Gusht 2022, jam faturuar në vlerën 385.00 lekë<sup>4</sup>. Kam bërë ankesë<sup>5</sup> pranë OSHEE por nuk kam marrë akoma asnjë përgjigje. Unë jam pensionist dhe nuk mund të paguaj për diçka që nuk e kam konsumuar. Pra diskriminohem sepse kam dy shtëpi (çdo shkak tjetër) dhe për të dy shtëpitë paguaj njësoj dhe pse vetëm njëra shtëpi është e banueshme nga unë. Nuk ndodh me askënd tjetër që në një banesë ku nuk ka konsum energjie

<sup>1</sup> Ankuesi ka lindur në datë 17.04.1939 dhe është pensionist.

<sup>2</sup> Ankuesi është pronar i dy shtëpive dhe ka të lidhura dy kontrata furnizimi me energji elektrike.

<sup>3</sup> Kodi i klientit: SH2A020006143998; Nr. Kontrate: A 143998; Numri i Faturës: 440048097.

<sup>4</sup> Kodi i klientit: SH2A020006143998; Nr. Kontrate: A 143998; Numri i Faturës: 438927388.

<sup>5</sup> Nr. Çështje: CSC2201022045, datë 20.10.2022, ora 08.09.

*të paguaj atë vlerë që më kanë vendosur mua, përveç vlerës së zakonshme që paguhet për kontratën”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe ndalimin e faturimit të paligjshëm nga ana e FSHU.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 1411/1, datë 01.11.202, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a për ankesën e bërë nga R.A. Në mënyrë të specifikuar është kërkuar:
  - Informacion në lidhje me situatën e faturimit të energjisë elektrike të ankuesit.
  - Kopje të procedurës së shqyrtimit të ankesës dhe të përgjigjes së dhënë ankuesit.
  - Informacion mbi historikun e faturimit të energjisë elektrike gjatë 12 muajve të fundit për Kontratën nr: A 143998, të klientit: SH2A020006143998.

Referuar dokumentit, Lajmërim marrje poste nr: RR239980803AA, datë 02.11.2022 rezulton se shkresa sipërcituar është marrë në dorëzim nga FSHU sh.a, e cila ka marrë dijeni për shkresën e mësipërme, në kushtet kur dokumenti është nënshkruar nga punonjësi i këtij Institucioni, ashtu dhe nga nëpunësi i shërbimit postar.

2. Në mungesë të përgjigjes së FSHU sh.a, nëpërmjet shkresës me nr. 1411/2, datë 23.11.2022, Komisioneri i është drejtuar sërish, përmes një shkrese kujtesë për dërgimin e informacionit, duke e njoftuar përsëri që brenda datës 01.12.2022 të paraqesë parashtrimet mbi çështjen në fjalë.

Në vijim, FSHU sh.a, pavarësisht faktit që ka marrë informacion lidhur me shkresën e sipërcituar, nuk ka depozituar asnjë dokument apo parashtrim lidhur me sa ka kërkuar Komisioneri në kuadër të shqyrtimit të ankesës në fjalë.

## **II. Pas kryerjes së hapave të mësipërm proceduralë, Komisioneri çmon se:**

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime dhe dokumentacion për ankesën sipërcituar, në mënyrë që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi të kishte mundësi të shqyrtonte këtë ankesë, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe të argumentuar në ligj, për konstatimin ose jo të diskriminimit. Komisioneri konstaton se FSHU sh.a me dijeninë e plotë nuk ka ofruar bashkëpunim dhe nuk ka

dhënë informacionin dhe dokumentet e kërkuara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminim.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në pamundësi të një informacioni të detajuar dhe verifikimit të dokumentacionit të kërkuar, është vënë në situatën e pamundësisë për të arritur në konkluzionin mbi trajtimin e pafavorshëm të shtetasit R.A.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 32/2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”*.

Neni 33/13, i ligjit të sipërcituar, ka përcaktuar se: *“Çdo person që shkel dispozitat e këtij ligji dënohet me gjobë si më poshtë”*: b) personi juridik nga 60.000 deri në 600.000 lekë.

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi arrin në konkluzionin se, Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a, është në shkelje të parashikimeve të bëra në nenin 32/2 dhe në neni 33/13, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pasi nuk ka vënë në dispozicion të Komisionerit, informacionin e kërkuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenet 1, 2, 3.1, nenin 7.1, nenin 21.1, nenin 32.1, gërma a), c) dhe ç) e pika 2, nenin 33.13 si dhe nenin 33/1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a, të gjobitet në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë, për mosdhënien e informacionit të kërkuar zyrtarisht nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
2. Gjoha të ekzekutohet dhe të derdhet në Buxhetin e Shtetit jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, vendimi i dhënë shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmarimit, me kërkesë të Komisionerit.
3. Pagesa e vlerës së gjobës të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi: 1091001, Entiteti i Qeverisjes: 1, Distrikti (TDO), Llogaria ekonomike: 7115499.

4. Dërgimi i informacionit të kërkuar nga Komisioneri, brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja dijani e Vendimit për sanksionin me gjobë, sjell shfuqizimin e tij.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**